

# TRANSPARENCA DHE KONSULTIMI NË VENDIMMARRJEN LOKALE

Analizë e procesit për paketën fiskale të Tiranës



Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

Përgatiti:

Ornela Liperi  
Freskida Miloti  
Mirbana Bilali  
Ramiola Kalemi  
Zamira Mustafaraj

## HYRJE

Reforma Administrative Territoriale e miratuar me anë të ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ishte një nga reformat më të analizuara e më të debatuar, e cila filloi të vihej në zbatim pas zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015. Reforma Territoriale në objektivin e saj primar mban përmirësimin e shërbimeve, rritjen e efikasitetit dhe fuqizimin e qeverisë, ndër to, ajo që synohet më së shumti përmes vënies në zbatim të kësaj reforme, është pikërisht rritja e transparencës dhe fuqizimi i demokracisë vendore.

Nisur nga objektivi primar i kësaj reforme e cila synonte përmirësimin e shërbimeve përmes rritjes së transparencës, uljes së fiktivitetit e çdo elementi të kufizuar edhe në ligjin mbi të cilin ngrihet kjo reformë, 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, bashkitë e sapozgjedhura, nisën reformat, duke ushtruar të gjitha kompetencat e zgjeruara, të cilat tashmë ligji në fuqi i siguronte.

Bashkia e Tiranës, e cila është edhe bashkia më e madhe në Shqipëri, nisur nga kompetencat e fituara përmes reformës, në datën 30.12. 2015, përmes Këshillit bashkiak, miratoi Vendimin Nr.59 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tiranë”<sup>1</sup>. Vendimi parashikonte rritjen e ndjeshme të një sërë taksash, si dhjetëfishimin e tarifës së zënies së hapësirës, dyfishimin e tarifave të pastrimit për biznesin e mesëm e të madh dhe vendosjen e një takse tërësisht të re, asaj të përkohshme për arsimin.

Siç do të vërtetohet në vijim, ky vendim pasqyroi një mangësi të thelluar në respektimin e detyrimeve ligjore, e mbi të gjitha reflektoi një reagim të madh ndërmjet bizneseve, vërehet se vendimi u mor pa asnjë lloj konsultimi paraprak me grupet e interesit, nuk u realizua një studim për gjendjen aktuale të bizneseve të Tiranës dhe aftësinë e tyre paguese referuar tarifave të reja. Gjithashtu, edhe pas miratimit të vendimit mungoi transparenca për t’ua bërë atë paraprakisht të ditura bizneseve. Pasi u njohën me nivelet e reja të taksave, bizneset reaguesh negativisht, sidomos ata të bareve e restoranteve që

---

<sup>1</sup><http://www.dpttv.gov.al/DocumentFile/Legjislacioni/Vendim%20Nr.59%20date%2030.12.2015%20Sistemi%20i%20taksave%20dhe%20tarifave%20vendore%20.pdf>

shfrytëzonin hapësira publike, pasi konstatuan se taksat në disa raste ishin në nivele të palogjikshme, duke arritur në 40% të xhiros<sup>2</sup>. Bizneset u ngritën në protesta masive në datën 23 shkurt.<sup>3</sup>

Kjo situatë e detyroi Bashkinë Tiranë të fillojë për herë të parë takimet konsultuese me përfaqësuesit e biznesit<sup>4</sup> dhe të rishikojë në ulje disa taksa bashkiake<sup>5</sup>, si ajo e zënies së hapësirës dhe të heqë tërësisht taksën e tavolinës, sipas vendimit Nr 8, datë 11.03.2016<sup>6</sup>. Fakti i tërheqjes së bashkisë është provë e hapur e mungesës së konsultimeve paraprake në procesin e hartimit të paketës fiskale.

Për të shmangur që situata të tilla, me pasoja të mëdha, të përsëriten në të ardhmen, qëllimi kryesor i temës, krahas evidentimit të pasojave që solli mungesa e transparencës dhe konsultimeve publike për paketën fiskale 2016, është të japë rekomandime për monitorimin paraprak të procesit të hartimit të paketës fiskale 2017 dhe të ushtrojë presion që të zbatohet ligji për qeverisjen vendore, që sanksionon transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen qytetare përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve.

## METODOLOGJIA

Burime të ndryshme janë konsultuar për hartimin e këtij punimi.

*Së pari*, ndërtimi i kronologjisë së ngjarjeve nga miratimi i paketës fiskale dhe deri më sot. Kjo është realizuar përmes kërkimit të artikujve në internet, që duke filluar nga shkurti 2016, kanë pasqyruar gjerësisht konfliktet e bizneseve me Bashkinë Tiranë, por dhe ndikimin që ka pasur tek sipërmarrjet rritja e taksave bashkiake. Janë vendosur *link* e artikujve përkatës atje ku citohen konkretisht në këtë punim. *Së dyti*, intervista me grupet e interesit; janë marrë intervista me këshilltarë bashkiakë, për të marrë informacion për procedurat e ndjekura në hartimin e paketës fiskale dhe konsultimit me grupet e interesit.

*Së treti*, janë konsultuar të gjitha vendimet e Bashkisë Tiranë marrë që nga fundi i vitit 2015 dhe që janë publikuar në faqen e internetit të bashkisë.

*Së katërti*, një vëmendje e rëndësishme i është kushtuar konsultimit të ligjit NR. 138/2015, për Vetëqeverisjen Vendore, konkretisht kreut VI “Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja qytetare”.

*Së pesti*, është konsultuar ligji i pushtetit vendos, përsa i përket fazës së përcaktimit të taksave dhe

<sup>2</sup> <http://www.mapo.al/2016/02/shokohen-bizneset-taksat-e-bashkise-sa-30-40-e-xhiros/1>

<sup>3</sup> <http://www.gazetatema.net/web/2016/02/23/biznesi-i-vogel-ne-proteste-per-taksat-e-reja-te-bashkise-tirane/>  
<http://www.oranews.tv/vendi/biznesi-i-vogel-proteste-kunder-rritjes-se-taksas-per-hapesiren-publike/>

<sup>3</sup> <http://shqiptarja.com/Ekonomi/2733/biznesi-nis-takimin-me-veliajnja-7-k-rkesat-p-r-rishqyrtim-taksash-344448.html>

<sup>4</sup> <http://www.monitor.al/terheqja-e-dyte-e-veliajt-hiqet-tarifa-e-tavolines-taksa-per-meter-katror-pershkallezohet-sipas-zonave-400-1500-leke-per-meter-katror/>

<sup>5</sup> <http://www.dpttv.gov.al/DocumentFile/Legjislacioni/VKB%20nr.8%20-%20Ndryshim%20paketa%20fiskale%20.pdf>

tarifave, duke qenë se është tashmë sipas ligjeve në fuqi një kompetencë e pushtetit lokal, pjesë e decentralizimit fiskal, ajo bëhet përmes këtyre hapave; Propozimi; Projekt – Vendimi; Diskutim në nivel komisioni, grupet e interesit; Miratimi; Zbatimi; Monitorimi i zbatimit të vendimeve ose nivelit të arkëtimit për përgatitjen e politikave fiskale.

*Së gjashti*, është konsultuar historiku i qeverisjes vendore dhe procesit të decentralizimit fiskal të viteve të fundit, për të kuptuar rolin e rëndësishëm që ka në vendimmarrje dhe qeverisje pushteti vendor. Reforma Administrative Territoriale e miratuar me anë të ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ishte një nga reformat më të analizuara e më të debatuar, e cila filloi të vihej në zbatim pas zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015. Shumë pikëpyetje nëse ishte një reformë e duhur në një moment të duhur dhe në shërbim të komunitetit, filluan të merrnin një përgjigje me funksionimin e Këshillave të rinj bashkiak nëpër rrethe. Reforma Territoriale në objektivin e saj primar mban përmirësimin e shërbimeve, rritjen e efikasitetit dhe fuqizimin e qeverisë, ndër to, ajo që synohet më së shumti përmes vënies në zbatim kësaj reforme, është pikërisht rritja e transparencës dhe fuqizimi demokracisë vendore.

## **PROCESI I DECENTRALIZIMIT NË SHQIPËRI (DECENTRALIZIMI FISKAL)**

Reforma e decentralizimit ka përparuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve 1999 dhe 2000, duke u bazuar te Kushtetuta (1998), Karta Evropiane për Vetëqeverisje Vendore (ratifikuar në nëntor 1999) dhe Strategjia Kombëtare e Decentralizimit, e miratuar në vitin 1999. Hapi specifik më i rëndësishëm ishte miratimi dhe zbatimi i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, që sanksionon të drejtat dhe kompetencat e njësive të qeverisjes vendore në përputhje me Kushtetutën dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Vendore dhe që u pasua nga ligje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e qeverisjes vendore dhe konsolidimin e Autonomisë.<sup>7</sup>

Vitet 2001 - 2002 mund të konsiderohen si më të suksesshmit në fushën e decentralizimit fiskal. Për herë të parë koncepti i transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor është miratuar në ligjin e buxhetit të shtetit të vitit 2001 dhe është zhvilluar më tej me paketën e reformës fiskale të miratuar nga Parlamenti në dhjetor të vitit 2002, duke rritur autonominë fiskale të bashkive dhe të komunave për të mbledhur të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore, si dhe përcaktimin e nivelit të tyre.<sup>8</sup>

---

6 Ligji për pronat e paluajtshme shtetërore dhe për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore te qeverisja vendore (2001), ligji për ndarjen territoriale dhe administrative të NJQV-ve (2000), ligji specifik “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” janë përgatitur dhe diskutuar e miratuar nga Parlamenti në të njëjtën kohë me ligjin për pushtetin vendor.

7 Botim i qëndrës së botimeve zyrtare, FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Viti:2015, Nr. 147, fq 4

Megjithë përpjekjet për të rritur autonominë fiskale, decentralizimi fiskal është hasur me shumë problematika, ku në pamundësi për të pësuar një rritje të buxhetimit të bashkive, taksat dhe tarifat vendore të vendosura, nuk kanë qenë në proporcionin e duhur me të ardhurat e përfituara nga bizneset, duke rënduar në këtë mënyrë dhe situatën ekonomike të tyre.

Kjo situatë e ka penalizuar shumë Shqipërinë, përkatësisht edhe bashkitë respektive duke e renditur nga vendet e fundit të Evropës Juglindore. Në aspektin e treguesve të decentralizimit fiskal, Shqipëria është shumë më mbrapa në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore.<sup>9</sup>

Reforma Administrative Territoriale e miratuar me anë të ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ishte një nga reformat më të analizuara e më të debatuarat e cila filloi të vihej në zbatim pas zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015. Shumë pikëpyetje nëse ishte një reformë e duhur në një moment të duhur dhe në shërbim të komunitetit, filluan të merrnin një përgjigje me funksionimin e Këshillave të rinj bashkiak nëpër rrethe.

Reforma Territoriale në objektivin e saj primar mban përmirësimin e shërbimeve, rritjen e efikasitetit dhe fuqizimin e qeverisë, ndër to, ajo që synohet më së shumti përmes vënies në zbatim kësaj reforme, është pikërisht rritja e transparencës dhe fuqizimi i demokracisë vendore.

## **Kuadri Ligjor i decentralizimit dhe procesi i tij në Shqipëri**

Garancia ligjore ndërkombëtare që garanton autonominë vendore, është:

- Karta Evropiane e Autonomisë Vendore që mund të konsiderohet si i pari instrument ligjor multilateral për përkufizimin dhe ruajtjen e parimeve për autonomi vendore. Karta përçon bindjen se niveli i vetëqeverisjes, që duhet të gëzojnë autoritetet vendore, mund të konsiderohet si një tregues i demokracisë në vend.<sup>10</sup>

---

<sup>9</sup> Botim i qendrës së botimeve zyrtare, FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Viti: 2015, Nr. 147, fq 6

<sup>10</sup> <file:///C:/Users/User/Downloads/Manuali%20i%20keshilltarit%20te%20bashkive.pdf>, fq 13

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) , përmes Nenit 11 të tij, “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore ”;
- Ligjin Nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” (Korrik 2000) i ndryshuar 2004/2015. Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Referuar llojeve të decentralizimit, mund të listojmë tre të tilla, përkatësisht politik, administrativ dhe ai fiskal. Çdo formë e decentralizimit, mbart në vetvete një proces delegimi përgjegjësish më shumë për pushtetin lokal përmes ushtrimit të disa parimeve themelore siç janë ai i subsidiaritetit, i cili është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke patur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efijencës dhe të ekonomisë.<sup>11</sup>

Në kuadër të këtij parimi dhe gjithashtu edhe të kuadrit ligjor përkatës, decentralizimit fiskal, kompetencat fiskale sipas Ligjit Organik, Neni 72/b janë:

- Merr pjesë në hartimin e buxhetit;
- Miraton buxhetin vendor (të detyrueshme mbledhjet me komunitetin);
- Monitoron buxhetin vendor me anë të krijimit të kontrolleve të brendshme financiare (Janar 2001) (Neni 21, Ligji Organik);
- Rekomandohet nëse mund të rishikohet paketa fiskale çdo vit;
- Vendos tarifa e taksa për kategori të ndryshme;
- Vendos nivelin e taksës me +10% - 30% (kushti...);
- Përcakton mënyrën e mbledhjes;

Përsa i përket fazës së përcaktimit të taksave dhe tarifave, duke qenë se është tashmë sipas ligjeve në fuqi një kompetencë e pushtetit lokal, pjesë e decentralizimit fiskal, ajo bëhet përmes këtyre hapave;

- Propozimi
- Projekt – Vendimi
- Diskutim në nivel komisioni, grupet e interesit;
- Miratimi
- Zbatimi
- Monitorimi i zbatimit të vendimeve ose nivelit të arkëtimit për përgatitjen e politikave fiskale.

Ajo që është mjaft e rëndësishme të theksohet, është fakti se çdo hap duhet të bëhet në transparencë të plotë, jo vetëm me forcat politike që përbëjnë Këshillin bashkiak dhe duhet të miratojnë këtë paketë, por sipas Ligji Nr. 138/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”, konkretisht KREU VI “TRANSPARENCA, KONSULTIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE”, NENI 16 Konsultimi publik në njësitë e qeverisjes vendore Pika 1 shprehet “Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes”.

Hapat për përgatitjen e paketës fiskale janë:



Sipas kësaj skeme, ajo që dukshëm vërehet është pikërisht rëndësia e konsultimit që është e barasvlershme për nga rëndësia e diskutimit në komisionet përkatëse dhe Këshillin bashkiak, që është një fazë e cila e paraprin fazën e Miratimit, Botimit e ma pas Zbatimit.

## MIRËQEVERISJA DHE TRANSPARENCA PUBLIKE NË PUSHTETIN LOKAL

Sa më sipër është analizuar dhe theksuar, objektivi primar i të gjithë reformës së Decentralizmit e tashmë Reformës Administrative –Territoriale që është pikërisht përmirësimi i shërbimeve, efikasiteti i tyre, shërbimet më pranë qytetarit dhe një reflektim më i shpejtë feedback-u për të realizuar një qeverisje të mirë në shërbim të qytetarit. Këtë konstatim e përcakton edhe Ligji në fuqi për vetëqeverisjen vendore, Ligjit 139, 2015, Neni 2 Pika 13. Reformat janë në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike.

“Shërbime publike” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Termi “qeverisje e mirë” është një term mjaft i përdorur kohët e fundit edhe pse një përcaktim dhe përkufizim përfundimtar ende nuk ka përsa i përket këtij termi, megjithatë kalimi që ka ndodhur nga nocioni i “qeverisjes” në atë të “qeverisjes së mirë” nënkupton një dimension shtesë referuar cilësisë së qeverisjes.

Një sistem i qeverisjes së mirë, rrjedh nga përmbushja e kërkesave të veçanta të procesit, në lidhje me marrjen e vendimeve dhe formulimin e politikave publike. Për shembull, hulumtuesit në Institutin e Bankës Botërore kanë dalluar gjashtë dimensionet kryesore të qeverisjes së mirë, ndër të cilat janë edhe *llogaridhënia, e cila përfshin liritë civile dhe stabilitetin politik; Efektivitetin e Qeverisë, duke përfshirë cilësinë e hartimit të politikave dhe të ofrimit të shërbimeve publike;*

Sikurse u përmend, nuk ekziston një përkufizim i vetëm për këtë koncept, por ajo që vihet re, në të gjithë përkufizimet është pjesëmarrja e transparenca si parakushte të një qeverisje të mirë. Kështu Kombet e Bashkuara, përcaktojnë një qeverisje të mirë, një qeverisje pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, të efektshme, të barabartë, si dhe promovimin e sundimit të ligjit.<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> United Nations Development Program, Governance for Sustainable Human Development (1997), <http://www.pogar.org/publications/other/undp/governance/undppolicydoc97-e.pdf>.



Sa më sipër, transparencja është një element thelbësor në procesin e vendimmarrjes dhe të qeverisjes së mirë në nivel të qeverisjes lokale. Kështu benefitet e transparencës në qeverisjen lokale janë, lehtësimi i ngritjes së kapaciteteve; rritja e legjitimitetit politik dhe mbështetja nga votuesit; Rritja e interesit në monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimit të projekteve; Përmirësimi në gjenerimin e të ardhurave. Transparenca rritet përmes konsultimeve publike, por lind pyetja, përse nevojiten konsultimet publike?

*Konsultimi në mënyrë më specifike duhet t'i shërbejë këtyre qëllimeve:*

- Të forcojë bazën empirike të sistemit të referimit për vendime të ndryshme, duke themeluar strategjinë e administratës në të dhëna sasiore dhe cilësore e sociale, financiare dhe organizative, të pasuruar nga kontributi i njohurive teknike dhe të specializuara të ekspertëve;
- Për t'ju përgjigjur kërkesave në rritje për pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike dhe për të siguruar dyer të hapura, transparencë në proceset vendimmarrëse, duke i bërë rezultatet e këtyre konsultimeve dhe metodat e vlerësimit të kontrollueshme;
- Të nxjerrin në pah ndonjë pasojë të padëshiruar të veprimtarisë administrative dhe të kontribuojnë për të grumbulluar konsensus për ndërhyrjet e propozuara, duke përfshirë alternativa të ndryshme;
- Të përmirësojë zbatimin e politikave duke vënë ex ante premisat për nxitjen e pajtueshmërisë me përfituesit dhe për të rritur cilësinë - në kuptimin e efektivitetit, sikurse dhe të efektivitetit të kostos (reduktim në kostot për rezultate të njëjta) dhe të efikasitetit (përmirësimin e raportit kosto / përfitim) – të aktiviteteve administrative.

### Transparenca dhe legjislacioni garantues

Që nga viti 2006 transparencja është trajtuar si një çështje veçanërisht e rëndësishme, si nga Këshilli i Ministrave dhe nga Komisioni European. Në fillim Këshilli European paraqiti politikën e saj të përgjithshme të transparencës.<sup>13</sup>

Duke ju referuar konsultimit si proces thelbësor në rritjen e transparencës, si mbi parimet e rregullimit më të mirë, *better regulation*, (të OECD, 1995, 1997), dhe - më së fundi - në Librin e Bardhë për reformën e institucioneve dhe politikave evropiane të miratuar nga Komisioni (Komisioni European, 2001, Qeverisja Evropiane. Libri i bardhë, COM (2001) 428 def., të 25.05.2001, Bruksel)<sup>14</sup>, bëjnë thirrje për përfshirjen sa më të gjerë dhe aktive të të gjitha palëve të përfshira, të interesuara në politikë bërje, sidomos qytetarët, grupet dhe bizneset.

<sup>13</sup> EC Treaty, supra note 3, art.251, O.J. C 325/33 (2002)

<sup>14</sup> [www.europa.eu.int](http://www.europa.eu.int)

Në të njëjtën kohë edhe legjislacioni shqiptar, përmes ligjit LIGJ NR. 138/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Kreu VI, KONSULTIMI DHE Pjesëmarrja Qytetare, përmes Nenit 15, “Transparenca e veprimtarisë së njësive të qeverisjes vendore”; Neni 16 “Konsultimi publik në njësitë e qeverisjes vendore”; Neni 17 “Mbledhjet e hapura të këshillit të bashkisë”; Neni 19 “E drejta e peticionit, ankesës dhe kërkesës”; Neni 20 “E drejta e iniciativës qytetare” .

## ANALIZIMI I RASTIT NË PËRPUTHJE ME INDIKATORËT

Për të analizuar rastin janë përdorur disa indikatorë të cilët janë në përputhje dhe të përcaktuar në ligjin NR. 138/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, konkretisht kreut VI “Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja qytetare”.

Nr	Indikatorët
1	Institucioni ka respektuar detyrimin ligjor të konsultimit paraprak me grupet e interesit.
2	Institucioni ka bërë transparente vendimet përmes botimit në faqen e internetit.
3	Reformat e ndërmarra kanë qenë të qëndrueshme dhe të pakthyeshme, çfarë tregon se kanë qenë të mirë analizuara para se të ndërmerreshin.
4	Marrja e informacionit nga grupet e interesit për çdo hap të ekzekutimit të vendimit.
5	Performanca e bashkisë në mbledhjet e taksave.
6	Ndryshimet në barrën fiskale.
7	Reagimet e bizneseve kundrejt reformës.
8	Institucioni ka respektuar procedurën e diskutimit në Këshillin bashkiak.
9	Institucioni ka publikuar rishikimin e buxhetit në linjë me taksat e tarifave të rishikuara.

Në datën 30.12. 2015, Këshilli bashkiak i Bashkisë së Tiranës miratoi Vendimin Nr.59 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tiranë”<sup>15</sup>. Vendimi parashikonte rritjen e ndjeshme të një sërë taksash, si dhjetëfishimin e tarifës së zënies së hapësirës, dyfishimin e tarifave të pastrimit për biznesin e mesëm e të madh dhe vendosjen e një takse tërësisht të re, asaj të përkohshme për arsimin.

<sup>15</sup><http://www.dpttv.gov.al/DocumentFile/Legjislacioni/Vendim%20Nr.59%20date%2030.12.2015%20Sistemi%20i%20taksave%20dh%20tarifave%20vendore%20.pdf>

Siç do të vërtetohet në vijim, vendimi u mor pa asnjë lloj konsultimi paraprak me grupet e interesit, nuk u realizua një studim për gjendjen aktuale të bizneseve të Tiranës dhe aftësinë e tyre paguese referuar tarifave të reja. Gjithashtu, edhe pas miratimit të vendimit mungoi transparenca për t'ua bërë atë paraprakisht të ditura bizneseve. Vendimi u botua në faqen e internetit në një vend jo të dukshëm, pa shënimin përkatës që ky është një legjislacion i ri <sup>16</sup>. Vetëm në shkurt të vitit 2016 sipërmarrjet u njohën me taksat e reja, duke u vënë në dijeni nga inspektorët, përmes mediave <sup>17</sup>, apo përmes leximit të tyre në sistemin online në faqet përkatëse të bizneseve.

Pasi u njohën me nivelet e reja të taksave, bizneset reagues negativisht, sidomos ata të bareve e restoranteve që shfrytëzonin hapësira publike, pasi konstatuan se taksat në disa raste ishin në nivele të palogjikshme, duke arritur në 40% të xhiros <sup>18</sup>. Bizneset u ngritën në protesta masive në datën 23 shkurt. <sup>19</sup> Kjo situatë e detyroi Bashkinë Tiranë të fillojë për herë të parë takimet konsultuese me përfaqësuesit e biznesit <sup>20</sup> dhe të rishikojë në ulje disa taksa bashkiake <sup>21</sup>, si ajo e zënies së hapësirës dhe të heqë tërësisht taksën e tavolinës, sipas vendimit Nr 8, datë 11.03.2016 <sup>22</sup>. Fakti i tërheqjes së bashkisë është provë e hapur e mungesës së konsultimeve paraprake në procesin e hartimit të paketës fiskale.

Nga sa u parashtrua më lart për mungesën e transparencës së Bashkisë Tiranë në procesin e hartimit të paketës fiskale 2016, rezulton se kjo sjellje ka pasur dy pasoja kryesore:

Së pari për vetë Bashkinë, e cila u detyrua të rishikonte me ulje taksash e tarifash paketën fiskale të vitit 2016, me efekt negativ në parashikimin e të ardhurave në buxhetin e po këtij viti, mbi bazë të së cilit ishin bërë dhe planifikimet për shpenzime dhe investime për banorët e kryeqytetit. Të dhënat mbi performancën e bashkisë për mbledhjen e taksave në raport me planin fillestar për 6 mujorin nuk janë ende publike. Nuk është bërë publik as rishikimi i buxhetit në linjë me taksat e tarifat e rishikuara. Kjo situatë ka bërë që të vendimet të mos ekzekutohen në kohën kur janë programuar dhe të shkaktojnë mospërputhje në buxhet, duke çorientuar sistemin financiar dhe menaxhimin e brendshëm <sup>23</sup>.

---

<sup>16</sup> <http://www.dpttv.gov.al/frmHtmlText.aspx?cnId=19&Page=Page>

<sup>17</sup> <http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/20/bashkia-e-tiranes-shumefishon-taksat-dhe-tarifat/>

<sup>18</sup> <http://www.mapo.al/2016/02/shokohen-bizneset-taksat-e-bashkise-sa-30-40-e-xhiros/1>

<sup>19</sup> <http://www.oranews.tv/vendi/biznesi-i-vogel-proteste-kunder-rritjes-se-taksas-per-hapesiren-publike/>

<sup>20</sup> <http://shqiptarja.com/Ekonomi/2733/biznesi-nis-takimin-me-veliajnja-7-k-rkesat-p-r-rishqyrtim-taksash-344448.html>

<sup>21</sup> <http://www.monitor.al/terheqja-e-dyte-e-veliajt-hiqet-tarifa-e-tavolines-taksa-per-meter-katror-pershkallezohet-sipas-zonave-400-1500-leke-per-meter-katror/>

<sup>22</sup> <http://www.dpttv.gov.al/DocumentFile/Legjislacioni/VKB%20nr.8%20-%20Ndryshim%20paketa%20fiskale%20.pdf>

<sup>23</sup> Intervistw me Reila Bozdo, këshilltare e djathtw bashkiake

Së dyti, dhe që është elementi më i rëndësishëm, paketa fiskale ka pasur kosto mbi bizneset, përmes rritjes së barrës fiskale, por edhe çorientimit të krijuar si rrjedhojë e mungesës së transparencës. Duke pasur parasysh efektet negative të biznesi, Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut ka depozituar në korrik të vitit 2016, në Gjykatën Kushtetuese Shfuqizimin e ligjit nr. 142/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë<sup>24</sup>.

Kërkesa është aktualisht në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Më herët ishte depozituar dhe kërkesa po nga Shoqata e Tregtarëve për shfuqizimin e taksës së përkohshme të infrastrukturës në arsim, pasi taksa e arsimit filloi t’u faturohet bizneseve për çdo NIPT sekondar<sup>25</sup>. Shoqata argumenton në akt padinë e saj se rritja e taksave vendore është jo vetëm disproporcionale, por vjen në kundërshtim të hapur me parimin e aftësisë paguese, i cili shprehet në mënyrë implicite në nenin 155 të Kushtetutës.

Nëse paketa fiskale do të ishte miratuar duke zbatuar kreun VI të ligjit NR. 138/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, “Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja qytetare”, kjo do të kishte mundësuar një vendimmarrje konsensuale, pa pasoja të mëpasshme, si në procesin e menaxhimit të buxhetit, ashtu dhe të performancës së bizneseve, duke mundësuar mirëqeverisjen vendore të bashkisë më të madhe në vend.

---

<sup>24</sup> <http://www.panorama.com.al/biznesi-con-taksat-vendore-ne-kushtetuese-neranxi-do-ta-fitojme-betejen/>  
<sup>25</sup> <http://www.mapo.al/2016/04/shoqata-e-tregtareve-con-taksen-e-arsimit-ne-gjykate-eshte-antikushtetuese/1>

## GJETJET KËRKIMORE

### *Moszbatimi i nenit për transparencën në ligjin për qeverisjen qendore*

Hartimi dhe miratimi i paketës fiskale 2016 nga ana e Bashkisë Tiranë është kryer me shpejtësi pa një konsultim paraprak me grupet e interesit. Vetë anëtarët e Këshillit Bashkiak janë njohur me draftin përmes dërgimit me e-mail në datën 25 dhjetor pasdite. Përveçse 25 dhjetori është pushim zyrtar, ishte ditë e premtë, pra dhe dy ditët në vijim ishin pushim, duke mos respektuar afatin për dërgimin e materialit 5 ditë pune përpara edhe në rregulloren e brendshme të Këshillit bashkiak, duke mos krijuar asnjë mundësi kohore për përcjelljen e këtij drafti te grupet e interesit dhe marrjen e mendimeve paraprake, që më pas të mund të reflektoheshin në draftin final.

Ligji për vetëqeverisjen vendore, neni 18, i jep një rol të veçantë Këshillave bashkiakë në organizimin e seancave dëgjimore. Konkretisht:

- *“Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë.*
- *Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.*
- *Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit " dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.*

Nuk ka pasur një studim paraprak të mirëfilltë, të realizuar nga Bashkia Tiranë, mbi efektet që do të kishte kjo paketë mbi grupet e prekura. Përfaqësuesit e bashkisë kanë realizuar një takim me drejtoreshën e Tatimeve të Tiranës dhe në bazë të statistikave që ato kishin nxjerrë u vendosën tarifa të

diferencuara nga qendra në periferi. Bashkia iu referua një analize rixsu të tatimeve për caktimin e nivelit të taksave<sup>26</sup>.

Nga kërkimet dhe bisedat me grupet e interesit dhe anëtarët e këshillave bashkiakë, nuk u gjet evidencë për konsultime paraprake të kryera me grupet e interesit dhe as për ndjekjen e hapave të parashikuara në nenin e transparencës në ligjin për qeverisjen vendore.

Ka disa evidence sporadike për konsulta me struktura të caktuara, por jo me grupet reale të interesit. Gjatë muajit dhjetor janë deleguar në Njësitë Administrative personat e posaçëm dhe nënkryetarët për takimet konsultative<sup>27</sup>. Këto takime janë zhvilluar në muajin dhjetor, përpara datës 25, pra përpara se të kishte një draft konkret të taksave e tarifave të reja. Bashkia Tiranë nuk na vuri në dispozicion procesverbalet e këtyre takimeve konsultuese.

Grupet e interesit<sup>28</sup>, që kanë qenë në kontakt me bizneset, deklaruan se nuk kanë qenë të ftuar dhe nivelin e taksave dhe tarifave të reja e kanë mësuar në shkurt, nga media dhe inspektorët e bashkisë. Këshilltarët bashkiakë, pjesë e procesit të vendimmarrjes e argumentuan se pavarësisht se më parë u bënë takime, reagimet masive nga biznesi erdhën për fakt se ata kishin bërë një interpretim të gabuar të taksave. Kryetari i Bashkisë u tërhoq, pasi ai donte të respektonte kërkesat e bizneseve<sup>29</sup>.

### ***Efektet negative te biznesi***

Rritja e nivelit të taksave pa u marrë në konsideratë treguesit makro-ekonomik sjell rritjen e mungesës së likuiditeteve për subjektet tatim paguese. Si një proces zinxhir, rritja e mungesës së likuiditeteve, ka efekte nga Biznesi i vogël pa TVSH, te Biznesi i vogël me TVSH, te Biznesi i madh, te Biznesi VIP dhe anasjelltas. Pra rritja e nivelit të taksave dhe tatimeve me ndikim vetëm në një nga llojet e subjekteve të sipërcituara, ka ndikim të menjëhershëm te subjektet e lidhura dhe simotra. Referuar treguesit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, kemi një frenim të kërkesave për regjistrim si person fizik dhe si person juridik, kjo nga Janari i vitit 2016 deri në Mars 2016. Në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2015, tremujori i parë i vitit 2016 shënon një frenim të kërkesës për regjistrim biznesi, i cili në mars 2016 është – 1.24%, nga +3.24%, në 2015. Pra është evident fakti se nisma për sipërmarrje të reja shënon një ulje drastike vetëm në tremujorin e parë, ç'ka në këtë rast përkthehet në frenim të iniciativës së lirë për të ushtruar një aktivitet tregtar<sup>30</sup>.

<sup>26</sup> Intervistë me Florjan Pullazi, anëtar i Këshillit Bashkiak, Partia Socialiste

<sup>27</sup> Intervistë me Florjan Pullazi, anëtar i Këshillit Bashkiak, Partia Socialiste

<sup>28</sup> Shoqatës për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut

<sup>29</sup> Intervistë me Florjan Pullazi, anëtar i Këshillit Bashkiak, Partia Socialiste

<sup>30</sup> Sipas argumentave në kërkesë padinë e Shoqatës për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut, dërguar në Gjykatën Kushtetuese, për shfuqizimin e taksave vendore

Janë 7571 biznese që kanë bërë kërkesë për t'u çregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) gjatë pesë muajve të parë të vitit, sipas të dhënave zyrtare nga QKB.

Sipas QKB, nga të dhënat statistikore rezulton se aplikimet për çregjistrim për periudhën kohore Janar – Maj vitin 2016 kanë pësuar një rritje prej 25% krahasuar me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2015.

### **Case study**

#### Taksat e Bashkisë po çojnë bizneset drejt mbylljes

*Auron Basha, sipërmarrës, në fund të vitit 2014 ka hapur një biznes me objekt aktiviteti bar-kafe, ushqim i shpejtë, me emër tregtar “The Rooms” në rrugën Sami Frashëri në Tiranë. Ai u kthye në Shqipëri për arsye familjare, duke bartur përvojën e një biznesi të ngjashëm në Finlandë. Auroni ishte një nga bizneset aktivë në protestat e shkurtit 2016, pasi taksat e reja bashkiake ishin të papërbalueshme. Në 15 shkurt 2016 atij i erdhi njoftimi i vlerësimit tatimor nga bashkia Tiranë, ku jepet vetëm shuma prej 75 mijë lekësh që duhet të paguante subjekti si detyrim total për tarifën e zënies së hapësirës publike për muajin janar 2016. Në të nuk sqarohej mënyra se si është llogaritur ky detyrim, as sipërfaqja që tatohet dhe tatimi për sipërfaqe. “Këto janë tarifa të çmendura, duhet të paguaj 150 mijë lekë për dy muaj”, thotë pronari i bar kafesë me një sipërfaqe prej 50 metrash në një lagje pranë stacionit të trenit. Ai pohon se me të ardhurat dhe shpenzimet që ka, me zor arrin të nxjerrë një rrogë për vete dhe fitimi mujor është shumë më i ulët se tarifa e zënies së hapësirës. “Kjo është një shifër shumë e çmendur që nuk e përballoj dot”, do të pohonte për mediat në atë kohë ai, duke shtuar që nuk ka rrugë tjetër veçse të mbyllë lokalit, me të cilin mbante gjithë familjen .*

*Në kuadër të kësaj eseje, gjatë punës kërkimore, e gjetëm dhe e takuam Auronin, në fund të gushtit 2016. Ai na tha se është drejt mbylljes së aktivitetit për shkak se taksat janë të papërbalueshme. “Vetëm taksat e bashkisë më vijnë 85 mijë lekë në muaj”, thotë ai. Janë tepër të larta dhe duhet të punoj 3-4 ditë vetëm për taksat e bashkisë, pa llogaritur dhe taksat e tjera si TVSH-në. Kur kisha lokalit në Finlandë paguaja për tre muaj sa më kërkojnë për një muaj këtu”. Ai realizon një xhiro prej 35-40 mijë lekë në muaj, por thotë se duke llogaritur qiranë, e kostot e tjera i del vetëm të paguajë dy banakiere dhe nuk i mbetet asgjë nëse do të paguante taksat. Ai pohon hapur se deri tani nuk ka paguar asnjë taksë ndaj bashkisë dhe po e çon me vetëdije biznesin drejt mbylljes, apo dhe sekuestrimit për mospagim taksash.*

## **KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET**

### ***Konkluzionet***

Procesi i hartimit dhe miratimit të paketës fiskale 2016 nga Bashkia Tiranë është shoqëruar me një mungesë totale transparence dhe nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në ligjin NR. 138/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, konkretisht kreut VI “Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja qytetare”. Paketa sanksionoi, pa konsultime, dhe pa një studim të efekteve të biznesi, rritjen e një sërë taksash e tarifash. Aktualisht Bashkia ka rishikuar me ulje disa prej tyre, pas protestave të bizneseve, si një provë e hapur e mungesës së konsultimeve paraprake në procesin e hartimit të paketës fiskale.

Mungesa e transparencës dhe konsultimeve paraprake, përveçse është shoqëruar me një konflikt të mëvonshëm mes Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrjeve, i pasqyruar gjerësisht edhe në media, që nga shkurti i vitit 2016, ka sjellë probleme si në procesin e menaxhimit të buxhetit të bashkisë, ashtu dhe të performancës së bizneseve.

Grupet e interesit e kanë dhënë mendimin e tyre pasi paketa fiskale kishte hyrë në fuqi, megjithatë mendimi dhe presioni i tyre ka pasur vlerë dhe është reflektuar nga bashkia. Megjithatë, kur ky konsultim bëhet i vonuar ka kosto financiare dhe shpenzim të energjive të panevojshme, që mund të ishin shmangur, nëse procesi i konsultimit do të ishte bërë në mënyrë të natyrshme dhe me transparence.

Si rrjedhojë, në rastin e miratimit të Paketës Fiskale 2016 nuk është arritur objektivi primar i të gjithë reformës së Decentralizimit e tashmë Reformës Administrative – Territoriale që është pikërisht përmirësimi i shërbimeve, efikasiteti i tyre, shërbimet më pranë qytetarit dhe një reflektim më i shpejtë feedback-u për të realizuar një qeverisje të mirë në shërbim të qytetarit.

### ***Rekomandimet***

Çdo hap në fazën e përcaktimit të taksave dhe tarifave vendore duhet të bëhet në transparencë të plotë, jo vetëm me forcat politike që përbëjnë Këshillin bashkiak dhe duhet të miratojnë këtë paketë, por sipas Ligji Nr. 138/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE” konkretisht KREU VI “TRANSPARENCA, KONSULTIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE”, NENI 16 Konsultimi publik në njësitë e qeverisjes vendore Pika 1 shprehet “Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes”.





Ligji për qeverisjen vendore i jep një rol të veçantë Këshillave bashkiakë në procesin e transparencës, siç është përmendur dhe më lart, ku është dhënë referenca ligjore, ku Këshilli bashkiak ka për detyrë të organizojë dëgjesat. Problemi, sipas intervistave me këshilltarë bashkiakë qëndron në faktin që nuk janë të përcaktuara qartë instrumentet se si mund ta bëjnë këtë, ndaj janë të nevojshme trajnimet dhe udhëzimet me afatet përkatëse që do të mundësojnë kalimin e të gjitha etapave të përcaktuara në ligjin për qeverisjen vendore. Këshilli bashkiak kalon projektin tek të gjithë këshilltarët dhe këta shkojnë t'i konsultojnë me komunitetin, por kjo kërkon kohë dhe deri tani, **afati prej 5 ditësh ka qenë tërësisht i pamjaftueshëm** dhe praktikisht nuk mundëson konsultimin për çështje të rëndësishme si në rastin konkret.

Gjithashtu edhe në rast se bëhet ndonjë rekomandim përgjatë mbledhjes së komisioneve të posaçme, nuk merren parasysh për shkak të votave të maxhorancë në Këshill bashkiak, apo për shkak të mbledhjeve të komisioneve që përgjithësisht bëhen ditën e mbledhjes së Këshillit. Ndërkohë nëse do të duhet të pasqyrojmë një shembull pozitiv është ai i qeverisë qendrore, që konsultimet për paketën fiskale të vitit të ardhshëm i fillon që në muajt e parë të vitit korent.

Rekomandimi më i rëndësishëm është **krijimi i një grupi të jashtëm monitorues**, i përbërë nga ekspertë, që do të ndjekë hap pas hapi procesin e hartimit të paketës fiskale 2017 dhe do të ushtrojë presion që të ndiqen të gjitha etapat e parashikuara në ligjin e qeverisjes vendore dhe nenin e transparencës dhe konsultimeve me grupet e interesit, siç është parashtruar në skemën e mësipërme. Në këtë grup do të marrin pjesë hartuesit e kësaj eseje, por do të ftohen edhe pjesëmarrës nga grupet e interesit dhe institucioneve që kanë dhënë konsulencë në procesin e decentralizimit të qeverisjes vendore (USAID).

**Këshilltarët bashkiak duhet të jenë më efektiv dhe mbledhjet bashkiake** duhet të kthehen në mbledhje të interesit të qytetarit dhe jo në diskutime politike, gjithashtu duhet të zbatohen procedurat, si lajmërimi përpara 5 ditëve pune, apo mbledhja e komisioneve dhe diskutimi për çështje të tilla në komisione jo ditën që do të bëhet mbledhja e Këshillit, por ditë përpara.

Për rritjen e transparencës në qeverisjen vendore një hap i rëndësishëm është gjithashtu edhe ai i **publikimeve në faqen e website-t të projekteve apo i projektimit të buxhetit**, në mënyrë që publiku, grupet e interesit të informohen paraprakisht, e në formë forumesh të mblidhen komente rreth parashikimit të projekt buxhetit.

Duhet të **aftësohen dhe trajnohen** nëpunësit publik, por edhe **anëtarët e Këshillit bashkiak** për të drejtat e detyrimit sipas ligjeve përkatëse, sikurse dhe të trajnohen rreth modeleve më të fundit të aplikuar në vendet e Bashkimit European, por edhe të rajonit për rritjen e transparencës dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në nivel lokal.

Indikatorët	Pasqyrimi i indikatorëve për rastin
<p>Institucioni ka respektuar detyrimin ligjor të konsultimit paraprak me grupet e interesit.</p>	<p>Nga kërkimet dhe bisedat me grupet e interesit dhe anëtarët e këshillave bashkiakë, nuk u gjet evidencë për konsultime paraprake të kryera me grupet e interesit dhe as për ndjekjen e hapave të parashikuara në nenin e transparencës në ligjin për qeverisjen vendore. Ka disa evidenca sporadike për konsulta me struktura të caktuara, por jo me grupet reale të interesit. Gjatë muajit dhjetor janë deleguar në Njësitë Administrative personat e posaçëm dhe nënkryetarët për takimet konsultative<sup>31</sup>. Këto takime janë zhvilluar në muajin dhjetor, përpara datës 25, pra përpara se të kishte një draft konkret të taksave e tarifave të reja. Bashkia Tiranë nuk na vuri në dispozicion procesverbalet e këtyre takimeve konsultuese.</p>
<p>Institucioni ka bërë transparente vendimet përmes botimit në faqen e internetit.</p>	<p>Vendimi u botua në faqen e internetit në një vend jo të dukshëm, pa shënimin përkatës që ky është një legjislacion i ri.</p>
<p>Reformat e ndërmarra kanë qenë të qëndrueshme dhe të pakthyeshme, çfarë tregon se kanë qenë të mirë analizuara para se të ndërmerreshin.</p>	<p>Bashkia u detyrua të rishikonte me ulje taksash e tarifash paketën fiskale të vitit 2016.</p>

<sup>31</sup>Intervistë me Florjan Pullazi, anëtar i Këshillit bashkiak, Partia Socialiste

Marrja e informacionit nga grupet e interesit për çdo hap të ekzekutimit të vendimit.	Vetëm në shkurt të vitit 2016 sipërmarrjet u njohën me taksat e reja, duke u vënë në dijeni nga inspektorët, përmes mediave <sup>32</sup> , apo përmes leximit të tyre në sistemin online në faqet përkatëse të bizneseve.
Performanca e bashkisë në mbledhjet e taksave	Të dhënat mbi performancën e Bashkisë për mbledhjen e taksave në raport me planin fillestar për 6 mujorin nuk janë ende publike. Nuk është bërë publik as rishikimi i buxhetit në linjë me taksat e tarifave të rishikuara.
Ndryshimet në barrën fiskale	Paketa fiskale ka pasur kosto mbi bizneset, përmes rritjes së barrës fiskale, por edhe çorientimit të krijuar.
Reagimet e bizneseve kundrejt reformës	-Shoqata për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut ka depozituar në korrik 2016 në Gjykatën Kushtetuese Shfuqizimin e ligjit nr. 142/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë <sup>33</sup> . Kërkesa është aktualisht në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.  Bizneset u ngritën në protesta masive në datën 23 shkurt. <sup>34</sup>

<sup>32</sup><http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/20/bashkia-e-tiranes-shumefishon-taksat-dhe-tarifat/>

<sup>33</sup><http://www.panorama.com.al/biznesi-con-taksat-vendore-ne-kushtetuese-neranxi-do-ta-fitojme-betejen/>

<sup>34</sup><http://www.gazetatema.net/web/2016/02/23/biznesi-i-vogel-ne-proteste-per-taksat-e-reja-te-bashkise-tirane/>  
<http://www.oranews.tv/vendi/biznesi-i-vogel-proteste-kunder-rritjes-se-taksas-per-hapesiren-publike/>

<p>Institucioni ka respektuar Procedurën e diskutimit në Këshillin Bashkiak.</p>	<p>Vetë anëtarët e Këshillit bashkiak janë njohur me draftin përmes dërgimit me e-mail në datën 25 dhjetor pasdite. Përveçse 25 dhjetori është pushim zyrtar, ishte ditë e premte, pra dhe dy ditët në vijim ishin pushim, duke mos respektuar afatin për dërgimin e materialit 5 ditë pune përpara edhe në rregulloren e brendshme të Këshillit bashkiak duke mos krijuar asnjë mundësi kohore për përcjelljen e këtij drafti te grupet e interesit dhe marrjen e mendimeve paraprake, që më pas të mund të reflektoheshin në draftin final.</p>
<p>Institucioni ka publikuar rishikimin e buxhetit në linjë me taksat e tarifat e rishikuara.</p>	<p>Të dhënat mbi performancën e bashkisë për mbledhjen e taksave në raport me planin fillestar për 6 mujorin nuk janë ende publike. Nuk është bërë publik as rishikimi i buxhetit në linjë me taksat e tarifat e rishikuara.</p>

## REFERENCAT

- Ligji për pronat e paluajtshme shtetërore dhe për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të qeverisja vendore (2001), ligji për ndarjen territoriale dhe administrative të NJQV-ve (2000), ligji specifik “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” janë përgatitur dhe diskutuar e miratuar nga Parlamenti në të njëjtën kohë me ligjin për pushtetin vendor.
- Botim i qendrës së botimeve zyrtare, FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Viti:2015, Nr.147, fq 4
- Botim i qendrës së botimeve zyrtare, FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Viti: 2015, Nr.147, fq 6
- <file:///C:/Users/User/Downloads/Manuali%20i%20keshilltarit%20te%20bashkive.pdf>, fq 13
- [http://www.europarl.europa.eu/ftu/pdf/en/FTU\\_1.2.2.pdf](http://www.europarl.europa.eu/ftu/pdf/en/FTU_1.2.2.pdf), fq2
- United Nations Development Program, Governance for Sustainable Human Development (1997), <http://www.pogar.org/publications/other/undp/governance/undppolicydoc97-e.pdf>. EC Treaty, supra note 3, art.251, O.J. C 325/33 (2002)
- [www.europa.eu.int](http://www.europa.eu.int)
- <http://www.dpttv.gov.al/DocumentFile/Legjislacioni/Vendim%20Nr.59%20date%2030.12.2015%20Sistemi%20i%20taksave%20dhe%20tarifave%20vendore%20.pdf>
- <http://www.dpttv.gov.al/frmHtmlText.aspx?cnId=19&Page=Page>
- <http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/20/bashkia-e-tiranes-shumefishon-taksat-dhe-tarifat/>
- <http://www.mapo.al/2016/02/shokohen-bizneset-taksat-e-bashkise-sa-30-40-e-xhiros/1>
- <http://www.gazetatema.net/web/2016/02/23/biznesi-i-vogel-ne-proteste-per-taksat-e-reja-te-bashkise-tirane/>
- <http://www.oranews.tv/vendi/biznesi-i-vogel-proteste-kunder-rritjes-se-taksas-per-hapesiren-publike/>
- <http://shqiptarja.com/Ekonomi/2733/biznesi-nis-takimin-me-veliajnja-7-k-rkesat-p-r-rishqyrtim-taksash-344448.html>
- <http://www.monitor.al/terheqja-e-dyte-e-veliajt-hiqet-tarifa-e-tavolines-taksa-per-meter-katror-pershkallzohet-sipas-zonave-400-1500-leke-per-meter-katror/>
- <http://www.dpttv.gov.al/DocumentFile/Legjislacioni/VKB%20nr.8%20-%20Ndryshim%20paketa%20fiskale%20.pdf>

## **INTERVISTAT ME GRUPET E INTERESIT**

- Intervistë me Florjan Pullazi, anëtar i Këshillit Bashkiak, Partia Socialiste;
- Intervistë me Reila Bozdo, anëtare e Këshillit Bashkiak, Partia Demokratike;
- Intervistë me Nikolla Neranxi, kryetar i Shoqatës për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe të Tregut;
- Intervistë me Besjan Besha dhe Panajot Soko, të “Nismës Thurje”;
- Intervistë me Auron Basha, sipërmarrës, Bar kafe “The Rooms”.